

V E N D I M
Nr.25, datë 24.6.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 7,21,29.3.1996 dhe 5.4.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.9 Akti, që i përket :

K E R K U E S : PEPE KANTOZI, i përfaqësuar nga Av. Thimjo Kondi.

SUBJEKT I INTERESUAR : SKENDER JAUPI, i përfaqësuar nga Av. Ilir Selenica.

O B J E K T I :

Deklarimi antikushtetues i Vendimit nr.555, datë 30.3.1994 të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Kërkuesi Pepe Kantozi, me kombësi izraelite, në fillim të vitit 1991 është larguar familjarisht nga Shqipëria në Izrael.

Ish-këshilli popullor i Lagjes nr.41, me vendimin nr.50, datë 6.7.1991, në bazë të nenit 287 të Kodit Civil në fuqi në atë kohë, ka urdhëruar zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesës me qiramarrësin Pepe Kantozi, për shkak të largimit të tij përgjithmonë nga Shqipëria, dhe ka autorizuar lidhjen e kontratës me zotin Skënder Jaupi e Ndërmarrjen Komunale Banesa nr.3. Kjo e fundit më datë 4.10.1991, këtë banesë ia ka shitur Pepe Kantozit. Për këtë shkak çështja është bërë menjëherë konflikt gjyqësor.

Pasi janë kaluar të gjitha instancat gjyqësore, Plenumi i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.555, datë 30.3.1994, ndër të tjera e ka quajtur të ligjshme zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesës me qiramarrësin Pepe Kantozi dhe e ka detyruar të lirojë banesën, për shkak të largimit të tij përgjithmonë nga Shqipëria.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i lartpërmendur i Plenumit të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues, pasi ai nuk është larguar përgjithmonë nga Shqipëria dhe se është mbështetur në fakte të paqena e të paverifikuara, duke iu prekur e drejta e lëvizjes së lirë, e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe garancia për një gjykim të drejtë, të parashikuara nga nenet 22, 38 e 40 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se, kërkuesi, në kundërshtim nga sa ka pretenduar, është larguar përgjithmonë me kërkesën e shkruar prej tij, drejtuar organeve kompetente. Ky fakt, sipas ligjit të kohës, përbënte një nga shkaqet për zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesës.

Në këto kushte, vendimi i Plenumit të Gjykatës së Kasacionit nuk ka të bëjë me të drejtën e lëvizjes dhe as e prek në ndonjë mënyrë këtë të drejtë të kërkuesit për të hyrë në Shqipëri.

I pabazuar është edhe pretendimi se është shkelur parimi i procesit të rregullt ligjor dhe i gjykimit të drejtë. Plenumi i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin e tij ka zbatuar normat procedurale e materiale në fuqi, duke mos cenuar ndonjë të drejtë kushtetuese të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 e Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për

dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë, përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 24.6.1996